




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

KONTRATË PËR SHËRBIME

E lidhur në mes të:

Komuna e Lipjanit – Zyra e Prokurimit përfaqësuar nga drejtori i Drejtori i Prokurimit z. Adem Duriqi në vazhdim (përmendet) Autoriteti kontraktues Dhe

Kontraktuesi N.P.N. Dardania, Jon Kukuzeli 35, 10000, PRISHTINË, Kosovë përfaqësuar nga Ekrem Gashi me numër të regjistrimit të biznesit, 811289843 në tekstin e mëtejshëm ("Kontraktuesi"), janë pajtuar të lidhin kontratë me titull

Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lindore Llot 2 – ritenderim

Numër të Prokurimit: 613-20-32-2-2-5

- i. Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e shërbimeve për: **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror 2019/2020, pjesa lindore Llot 2 me nr. të brendshëm të prokurimit 613 20 091 521,**
- ii. Duke u bazuar në kërkesën për shërbime për komunitetin Drejtoria e shërbimeve Publike ka parashtruar kërkesë për lidhjen e kontratës për këto shërbime, **Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lindore Llo** Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin kontratë për kryerjen e shërbimeve sipas ofertës së datës **16/01/2020**
- iii. **ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:**

1. Kontraktuesi do t'i kryej shërbimet sipas nevojës dhe do të jetë në gjendje gadishmerie sa herë të paraqitet nevoja të intervenojë me mjetete e vete për shpërndarjen e kripes dhe rërës dhe largimin e borës dhe akullit nga rruga

SPECIFIKIMET PER MIRËMBAJTJEN DIMËRORE TË RRUGËVE RURALE

LIPJAN - 2019/2020

Aktivitetet e parapara për realizimin e punimeve në mirëmbajtjen dimërore të rrugëve rurale:

a) Largimi I Borës nga rruga:

b) Hedhja e krypës të kombinuar me rërë :

Gjatë ditëve me reshje bore Kontraktuesi duhet të përgaditet paraprakisht në mënyrë që të ketë të gjitha mjetet e nevojshme në dispozicion dhe në gjendje të mirë teknike.

Largimi I borës nga rrugët duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë 24h në të gjitha rrugët.

Për çdo ditë të reshjeve të borës varsishtë nga koha kur fillojnë , fillimi I punës duhet të jetë I menjëhershëm pas fillimit të reshjeve.

Nëse ato janë të pandërprera largimi I borës dhe akullit duhet të bëhet pa ndërprerë, ku të gjitha rrugët duhet të jenë të pastruara nga bora dhe akulli, para kohës kur veq fillon fluksi i automjeteve

(ora 7 e mengjesit)

Në rast se kompanija nuk e përfill planin e organizimit të punës , atehere do të pasohet me nderprerje të kontratës dhe OE do të shpallet i papërgjegjshëm.

Vrejëtje: Në rastë të mos largimit të borës dhe akullit nga rrugët , kompanisë do ti minusohet shuma për pastrimin e atyre rrugëve.

Në rastë kur kompanija pranon vrejten , vazhdon mosperfilljen e rrespektimit të marrëveshtjes atëhere kompanisë do ti shkputet kontrata.

Kur kompanija ka defekte në makineri, duhet të lajmroj organin mbikqyrës ose me imail : dhe duhet të caktoj kohen kur mundet të filloj me shërbime.

në rastë kur mekanizmi nuk mundë të rregullohet mbrenda ditës, operatori është i obliguar të huazoj apo të marrë makineri me qera për perfundimin e shërbimeve të kontraktuara, në të kundërtën operatori do të shpallet i papërgjegjshëm.

Hedhja e krypës e kombinuar me rërë duhet të bëhet kur temperaturat nuk arrijnë -6° C në rastë se temperaturat kapin vlerat më të ulëta kompanija duhet te perdorë makineri (Greder) per heqjen e bores dhe akullit nga rruga .

Kompanija duhet të intervenoj pas fillimit te reshurave ku trashesia e bores arrin trashesisë 3 cm

Kontraktuesit do ti bëhet pagesa vetem per shërbimet e kryera, kur rruget konstatohen se jan te pastruara nga bora dhe akulli per qdo intervenim te hedhjes se krypes dhe rëres , ndersa per rruget te cilat nuk jan te pastruara mbrenda 24^h

pas reshjeve nuk do te paguhen, si dhe do te minusohen me penalti 10 € per Km qdo ditë te papastruar.

**Kompanija duhet të ketë kujdestari 24^h
gjatë sezonit dimërorë:**

2.2 Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është ditën e nëshkrimit të kontratës

2.3 Data e Përfundimit është 15 prill 2020

Neni 3

Vendi i kryerjes së shërbimeve është

Për llot 2rrugët e komunës së Lipjanit në pjesen lindore të qytetit të Lipjanit të përshkruara në tabelë

Punë të planifikuara							
Pershkrimi i rrugëve	Gjatësi (m')	Gjersia m	siperfaqja - me asfalt m ²	Sasia e hudhjes se kripes kg/m ²	Ditë të planifikuara me reshje per hedhje te krypes	Sasia e hudhjes se kripes ne (Kg) m ² ditore	Sasia e hudhjes se kripes kg/m ² per 20 ditë
Hekurudh-Kojnsk	5510	4.00	22040.00	0.020	20.00	440.80	8816.00
Rubovc I Vogel	1300	4.00	5200.00	0.020	20.00	104.00	2080.00
Rubovc I Madhë	3500	4.00	14000.00	0.020	20.00	280.00	5600.00
Llugaxhi	4500	4.00	18000.00	0.020	20.00	360.00	7200.00
Gomnasellë	3000	4.00	12000.00	0.020	20.00	240.00	4800.00
Banullë	9000	4.00	36000.00	0.020	20.00	720.00	14400.00

Glllogovcë	6000	4.00	24000.00	0.020	20.00	480.00	9600.00
Akllap	5000	4.00	20000.00	0.020	20.00	400.00	8000.00
Janjevë	6500	4.00	26000.00	0.020	20.00	520.00	10400.00
Teqe	2000	4.0	8000.00	0.020	20.00	160.00	3200.00
Sllovijë	7500	4.00	30000.00	0.020	20.00	600.00	12000.00
Sllovijë-Terbovc	5000	4.00	20000.00	0.020	20.00	400.00	8000.00
Smallushë	6900	4.00	27600.00	0.020	20.00	552.00	11040.00
Qallapek	1200	4.00	4800.00	0.020	20.00	96.00	1920.00
Gadime e Ultë-e Eperme	15000	4.00	60000.00	0.020	20.00	1200.00	24000.00
Babushë I Muhagjerve	5500	4.00	22000.00	0.020	20.00	440.00	8800.00
Vrellë e Gadimes	5500	4.00	22000.00	0.020	20.00	440.00	8800.00
Marevc- Gllavicë	2900	4.00	11600.00	0.020	20.00	232.00	4640.00
Gadime - Smallushë	3500	4.00	14000.00	0.020	20.00	280.00	5600.00
Gad e Eperme- Gllavicë	3500	4.00	14000.00	0.020	20.00	280.00	5600.00
Brus	5900	4.00	23600.00	0.020	20.00	472.00	9440.00
Vrellë - Plitkoviq	3500.0	4.00	14000.00	0.020	20.00	280.00	5600.00

Neni 4

Norma e dëmeve të likuiduara është 10 € në ditë per çdo Km të rrugëve të papastruar nga bora dhe akulli, që janë pengesë për komunikacion .

Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 25% të çmimit final të kontratës

Neni 5 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

- Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: Nëse ndodh ndonjë dëmtim lidhur me shërbimet, gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që shërbimet e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës.;
- Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;
- Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar.
- Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar.
- Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizua

Neni 6 Sigurimi i ekzekutimit

Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vleres së përgjithshme të kontratës për 4 muaj

Neni 7 Çmimi i shërbimeve

Çmimi i shërbimeve është gjithsej: 28228.96 **njëzet e tetë mijë dyqind e njëzet e gjashtë euro e nëntëdhjet e gjashtë cent** sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna ne Dosjen e tenderit nr. 613 20 32 221

Neni 8 orari i pageses

Orari i pagesës do të jetë: pagesa do të kryhet në fund të sezonit dmth do të kemi vetëm një pagesë, nëse ka penale , menaxheri i kontratës do t'i llogarit dhe do të zbret faturën për vlerën e penaleve. Pozicioni 1 nga tabela1 do të paguhet vetëm për intervenimet e kryera, pozicioni 1 nga tabela 2 furnizimi dhe hudhja e kripes do të paguhet vetëm sasia e krypës e cila është hargjuar ndërsa pozicioni 2 tabela 2 do të paguhet në tërësi , çmimi në këtë pozicion (tabela2 pozicioni 2) nuk mund të jetë më i lartë se 50% e vlerës së përgjithshme të ofertes. Nëse vendoset çmim më i lartë oferta e tillë automatikisht do të refuzohet .

pozicioni 3 tabela 2 do të paguhet vetëm për shërbimet e kryera

Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave është e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 9 inspektimi

Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: menaxheri i kontratës do të kontrollojë shërbimet e kryera dhe nëse kemi borë dhe akull edhe pas 24 orëve pas ndalje së të reshurave do llogarisë penalet sipas 4 të kësaj kontrate

Neni 10 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes

Palët Kontraktuese pajtohen që kontestet eventuale që lindin me rastin e dispozitave të kësaj kontrate të zgjidhin me marrëveshje. Afati për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët kontraktuese pajtohen që të jetë 15 ditë nga dita e paraqitjes së kontestit nga ana e palës do t'i dorëzohen për arbitrim

Komisioni përbrenda Komunës, ose deri në instanca më të larta që do të përbëhet nga drejtori i administratës,, drejtori i prokurimit dhe drejtori i Planifikimit dhe urbanizëm dhe përfaqësuesi i kontraktuesit.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore

a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Lipjan në pajtim me ligjin në Kosovë, ose

b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Përshkrimi i Shërbimeve të kërkuara nga njësia kërkuuese që duhet të realizohen;
- Njoftimi në KRPP për shërbime në procedurë te negocuar .

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktuesin		Për Kontraktuesin	
Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Ekrem Gashi
Pozita:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	DREKTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.01.2020	Data:	24.01.2020
Vula:		Vula:	

Mirëmbajtja dhe pastërtia e rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror pjesa lindore Llot 2

Poz.	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi njësi	shuma për një herë	shuma e përgjithshme për 20
1	Largimi i borës nga rrugët sipas specifikacioneve të parapara me aktivitetet: a) largimi i borës nga rruga. b) hedhja e kripës me rërë. Vërejtje: me këtë pozicion duhet të jepet çmimi për m ² për Largimin e borës si dhe hedhjen e kripës 20gr për m ² për një intervenim , sipas specifikimit për mirëmbajtjen e një metri katror për rrugën ose trotuarët në qytet, çmimi të llogaritet për një sezon deri 31 Mars 2020 i cili mund të jete deri ne 20 intervenime	m ²	448,840	0.0016	718.144	14,362.88
shuma tab1						14362.88

Poz.	Përshkrimi	Njesia	Sasia	çmimi njësi	vlera
2	Pastërtia dhe depozimi i kripës dhe rrugëve sipas specifikacioneve të parapara me aktivitetet: 179535 kg. O.E pagosa do t'i bëhet vetëm për sasinë e shpenzuar gjatë sezonit	kg	179,535	0.03	5,386.08
3	Kompania duhet të caktoj çmimin për kujdestari gjatë sezonit dimëror deri më 31 Mars 2020	sezonë	1	8000	8,000.00
4	Pastërtia dhe depozimi i kripës nga shërbimet e dhëna (gërvo) nëse paraqitet nevojë gjatë sezonit dimëror, të llogaritet ngarkimi, transporti deri në depozitë në gjatësi 5 km	m ³	60	8	480.00
Shuma tab 2					13,866.08

Rekapitullim	
shuma tab 1	14362.88
shuma tab2	13866.08
shuma përgjithshme - Llot 2	28228.96

